



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 6441 / Prot.

Tiranë, më 30.07.2018

Nr. Identifikimi 545

Vendimi 33

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Emri i Subjektit: “A. N. K” sh.p.k.

Nr. NIPT-i: J9208001N

Adresa e selisë: Rruga e Kavajës, Pallatet Condor, Kulla 1, Hyrja I, Kati I tretë, Tiranë

Personi përgjegjës: Agim Kola

Për të zhvilluar projektin: “**Shfrytëzim me karrierë e mineralit të gurit gëlqeror**”

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Verësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Fshati Floq, Korçë

Sipërfaqja totale: 0.0805 km²

Lloji Mineralit: Gurë Gëlqeror

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

**1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:
Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen:**

- Rekomandojmë mbajtjen parasysh të referencave ndaj ligjit të pyjeve dhe të dhënave kadastrale për pyjet dhe kullotat.
- Subjektit t'i vendoset kusht që t'i përmbahet kërkesave të ligjit nr. 10266 datë 15.04.2010 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", i cili amendon ligjin nr. 8897 datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja" dhe VKM-së nr.435 datë 12.09.2015 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, subjekti duhet të hartojë një plan masash paraprake për të ulur shkarkimet në ajër.
- Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet me shkresë Nr. 828/1 datë 09.07.2018:
Pas verifikimit të koordinatave të ndryshuara rezulton se aktiviteti nuk prek Zona të Mbrojtura apo Monumente Natyre

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitorëve iu siguria të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos çenuar jetën e banorëve.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Me kontratën nr. 2197/6 datë: 28.06.2013 me objekt: "Sistemim Asfaltim rruga Korçë-Ersekë Loti 1" palët Kontraktore Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë "ANK sh.p.k.&Agri Konstruksion sh.p.k. & Klajger Konstruksion sh.p.k"

- Me kontratën nr. 6182/5 datë: 11.09.2017 me objekt: "Plotësimi i punimeve të mbetura dhe lidhja në rrugën ekzistuese të objektit Sistemim Asfaltim rruga Korçë-Ersekë Loti 1" palët Kontraktore Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Operatori Ekonomik "A.N.K sh.p.k."
- Urdhër Nr. 195 datë 08.1.2017 për ndryshimin e koordinatave të lejes minerare Nr. 847/2 datë 03.04.2015 për shfrytëzimin e gëlqerorëve në objektin "Floq", Qarku Korçë.

Pika	Ishin		Pika	Bëhen	
	Kordinatat			Kordinatat	
	X	Y		X	Y
1	4487034	4474019	1	4487108	4474619
2	4487228	4473957	2	4487106	4474170
3	4487342	4474347	3	4487175	4474167
4	4487120	4474365	4	4487175	4474167
			5	4487275	4474354
			6	4487300	4474748
Sipërfaqja = 0.0805 km ²			Sipërfaqja = 0.0805 km ²		

- "Planin e veprimit për veprimtaritë minerare ndërtimore", sipas Urdhërit të përbashkët Nr. 67, datë: 11.03.2018, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
- 4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:
 - 4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 - 4.2 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
 - 4.3 Kjo deklaratë është e vlefshme pas miratimit nga MIE për Lejen e Shfrytëzimit.
 - 4.4 Kjo Deklaratë është e vlefshme vetëm për shfrytëzimin e gëlqerorëve sipas koordinatave të ndryshuara nga MIE, që do të shërbejnë si lëndë e pare për shtrimin e rrugës Korçë-Ersekë Loti 1
 - 4.5 Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.
- Gjatë fazës së instalimit:**
 - 4.6 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore
 - 4.7 Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)
 - 4.8 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
 - 4.9 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
 - 4.10 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.

- 4.11 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.12 Të sistemohen brenda sipërfaqjes së shfrytëzimi të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.13 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.14 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe për mirësuar pejsazhin.
- 4.15 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësi vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
- 4.16 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.17 Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.18 Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.19 Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
- 4.20 Në përfundim të rrugës të njoftohen organet licensuese të këtij aktiviteti.
- 4.21 Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit nr. 60/2014 datë 19.6.2014, "Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për Lejet e Mjedisit", të ndryshuar, Shtojca I, duhet t'i nënshtrohet procedurave për paisje me Leje Mjedisore.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 "Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së", ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM


EDISON KONOMI



MINISTRI

BLENDI KLOSI

Aneksi 1. Harta me koordinatat



MINISTRIA E INFRASTRUKURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË MINIERAVE
OBJEKTI "Flog", Qarku Korçë

Loja nr. Loja Nr.847/3
 Subjekti "A. N. K." sh.p.k
 Minerali Gur gëlqeror
 Lloji i lojes Shfrytëzim
 Sipërfaqja, km² 0.0805
 data
 Neritan Aleks 02.11.2017